

Në përputhje me Nenin 28 paragrafi 3 i Ligjit 9723/2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", ky dokument është



**AKT I THEMELIMIT**

**DHE**

**STATUTI**

**I**

**SHOQËRISË**

**STARTECH GROUP SH.P.K**

**Data: 23 MARS 2023.**



## STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

### " STARTECH GROUP SH.P.K"

Në bazë të zbatimit të ligjit:

- Nr. 9901, date 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" më poshtë referohet si "Ligji Për Shoqërite";
- Nr.7512 date 10.08.1991 " Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë,si dhe të veprimtarisë private dhe privatizimit";
- Nr.9723 , date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" veprimtaria e shoqërise **Startech Group sh.p.k.**

**do të organizohet dhe do te drejtohet sipas ketij Statuti te trajtuar në të njëjtën dokument me Aktin e Themelimit.**

### PJESA E PARE DISPOZITA TE PERGJITHSHME

#### Neni 1 Ortakët

1.1 Ortakët e shoqërise jane :

1. **Ilfa Stavre**, atësia Klaid, shtetase Shiptare, e lindur me 25/12/1997 në Kavaje, banuese ne Kavaje , Laqja nr. 2, Rruga e Shëngjergjit, Nd .10, Apt 6 Kavaje, 2501, e indentifikuar me Letërnjoftim numër personal **J76225066T**, madhore dhe me zotësi juridike të plotë për të vepruar.
2. **Sokol Saliq**, atësia Namik, shtetas Shqiptar, lindur me 14/10/1989 në Lushnje, banese ne Tirane me adrese Rruga "Perlat Rexhepi", Nd.1, H.6, Ap. 12, Njesia Administrative Nr. 5, Njesia Bashkiake Nr.5, 1019, Tirane, i identifikuar me Letërnjoftim numer personal **191014045T**, madhor dhe me zotesi juridike te plote per te vepruar.

## Neni 2

### Emri

Emri i shoqërisë është *Startech Group sh.p.k* (më poshtë referuar si "Shoqëria").

## Neni 3

### Selia e Shoqërisë

3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: *Rruga Kosovareve, Pallati Doleka, Apartamenti Nr.A, kati 2, Njesia bashkiake Nr.5 Tirane*

Adrese elektronike: [eris.tare@outlook.com](mailto:eris.tare@outlook.com)

Telefon: +355693396244

Shoqëria mund të hapë dege, zyra perfaqesimi brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe atij të huaj në fuqi.

## Neni 4

### Forma ligjore

4.1. Shoqëria është shoqëri shqiptare dhe është krijuar si **shoqëri me përgjegjësi të kufizuar**.

## Neni 5

### Kohëzgjatja

5.1. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj tregtar për një periudhë të pacaktuar (pakufizuar).

## Neni 6

### Objekti i aktivitetit

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë **Startech Group sh.p.k.** konsiston në :

- Pikë servisi, tregti me pakice të makinave dhe pjesëve të tyre.
- Dhënie me qera e automjeteve të çdo lloji.
- Tregtim automjeteve dhe dhënie me qera si perfaqesues apo shoqëri të qirave ndërkombëtare të mjeteve detare lundruese të çdo lloji.
- Shit-blerje brenda dhe jashtë vendit të mjeteve motorrike të çdo lloji dhe riparimi tyre.
- Ndryshime konstruktive të mjeteve motorrike tokësore dhe atyre ujore të çdo lloji.
- Transport kombëtar dhe ndërkombëtar mallrash dhe pasaqjesh për vete dhe të Tretë

- 6.2. Shoqëria mund të kryejë edhe aktivitete të tjera shtesë, me qëllim përmbushjen e veprimtarisë së saj kryesore në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

**PJESA II**  
**KAPITALI I SHOQËRISË DHE KUOTAT**

**Neni 7**

**Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali i shoqërisë është 10,000 (dhjetë mijë) Leke i marrë persiper dhe i nënshkruar nga ortakët.

Kapitali themeltar është i ndarë në 2 (dy) kuota nga 5.000 leke/kuotë, e cila zotërohen nga ortakët si më poshtë :

Ortaku	Kuotat e Nenshkuara	Vlera në Leke	Perqindja (%)
ILFA STAVRE	1	5,000	50%
SOKOL SALIAJ	1	5,000	50%
<b>Total</b>	<b>2</b>	<b>10,000</b>	<b>100%</b>

**III. STRUKTURA DREJTUESE**  
**TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKUT/ORTAKEVE**

**Neni 8**

**Pergjegjësia e kufizuar**

8.1. Ortakët janë përgjegjës deri në vlerën e pjesës së tyre në kapitalin e Shoqërisë. Shoqëria është përgjegjëse për detyrimet e saj me të gjitha asetet.

**Neni 9**

**Të drejtat e lidhura me çdo kuotë**

9.1. Çdo kuotë e secilit ortak do t'i përgjigjet një vote korresponduese në mbledhjet e ortakëve dhe do t'i japë ortakëve të drejtën për të marrë dividende në rast shpërndarje të fitimit si dhe të drejtën e pjesës përkatëse që mbetet pas procedurave të likuidimit në rast prishje apo likuidimi të Shoqërisë.

**Neni 10**  
**Fitimi dhe kalimi i kuotave**

10.1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a. kontibutin në kapitalin e shoqërisë;
- b. shit-blerjes;
- c. trashëgimisë
- d. dhurimit
- e. cdo mënyre tjetër parashikuar me ligj.

10.2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata do bëhet me shkrim.

**Neni 11**  
**Detyrimet e Ortakeve**

11.1 Ortakët kanë detyrim të paguajnë pjesën e tyre, të marrin pjesë në mbledhjet e asamblese nëse ftohen ose njoftohen në menyrën e duhur, të mbështesin Shoqërinë në kryerjen e veprimeve të saj si dhe të permbushin vendimet e mbledhjes së ortakëve dhe organeve të tjera të Shoqërisë të cilat janë marre në menyrën e duhur brenda qëllimit të organit përkatës.

(aa) Lidhjen e marrveshjeve për dhënien e huave

12.4 Asambleja e përgjithshme do të ketë të drejtë të vendosë mbi cdo çështje që tejkalon aktivitetin e përditshëm të shoqërisë.

**Neni 12**  
**Të drejtat e asamblesë së përgjithshme**

12.1 Asambleja e përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë e cila ka të drejtë të marre vendime në lidhje me të gjitha çështjet e veprimtarisë së saj.

12.2 Asambleja e përgjithshme përbëhet nga të gjithë ortakët zotërues të kuotave.

12.3 Vetëm asambleja e përgjithshme ka të drejtë të vendosë përse i përket më poshtë:

- (a) ndryshime dhe modifikime të Statutit;
- (b) pranimin e ortakëve të rinj (pas rritjes së kapitalit apo transferimit të kuotave);
- (c) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit dhe/ose cdo lloj pagimi të pjesëmarrësve ose subvencionit të dhënë nga ortakët;
- (d) bashkimin, ndarjen, prishjen dhe cdo lloj transformimi të Shoqërisë;
- (e) blerjen apo disponimin e interesit pjesëmarrës në shoqëri shqiptare apo të huaja;
- (f) hapjen dhe mbylljen e degëve dhe zyrave të përfaqësimit;
- (g) pjesëtimin dhe anulimin e kuotave;
- (h) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjerë ndaj administratorëve;
- (i) miratimin e raporteve vjetore dhe bilancit të shoqërisë si dhe shpërndarjen e fitimit;
- (i) blerjen, shitjen dhe dhënien peng të pasurive të paluajtshme;

- (k) marrjen me qira, dhenien me qira ose dhënien e cdo te drejte për përdorimin e pasurive të paluajtshme dhe ndërtesave;
- (i) te vendose për investimet;
- (m) të jap letra me vlere, te marre detyrime, te leshoje garanci ose letra sigurie
- (n) te percaktoje parimet e pergjithshme te politikave te shoqerisë;
- (o) te caktoje shperblimet per administratoret, te perfundoje kontratat e punes me administratoret dhe nëpunësit ekzekutive të shoqërisë;
- (p) te japë alternativa, te drejta te ndarjes se fitimit vjetor, pagesave ne natyre, te drejta mbi pensione ose cdo paqese mbi largimin e drejtorëve, dhe nepunësve ekzekutive te shoqërisë;
- (a) të perfundoje marrëveshje konsultimi dhe bashkepunimi;
- (r) emerimin dhe shkarkimin e likujduesve, ekspertëve kontabël te autorizuar;
- (s) emerimin dhe shkarkimin e administatoreve;
- (t) percaktimin e shperblimeve per likujduesit, ekspertet kontabel;
- (u) mbikqyerjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret;
- (v) miratimin e rregullave te brendshme mbi administrimin dhe mbledhjes se asamblese;
- (ë) përcaktimin e struktures organizative dhe administrative te Shoqërisë;
- (x) përcaktimin e buxhetit vjetor;
- (y) miratimin e cdo cështje tjetër zgjidhja e se ciles i eshte rezervuar asamblesë se pergjithshme ne perputhje me ligjin dhe këtë Statut.
- (z) Marrjen e huave në emër te shoqerise dhe vendosjen e kushteve te huase

Kapitali themeltar eshte vetem ne monedhën vendase, në lekë.

Kapitali i nënshkruar do të derdhet ne llogarite bankare të shoqerise nga ortakët jo me vonë se 60 ditë nga themelimi i shoqerisë dhe jo më vonë se 50 ditë nga regjistrimi i saj në regjistrin tregtar.

### Neni 13

#### Vendimet e asamblese se pergjithshme

13.1 Vendimet e renditura përse i përket ndryshimit të statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë merren me 3/4 (tre të katertat) e votave të ortakëve pjesëmarrës.

## **Neni 14**

### **Thirrja e asamblese se pergjithshme**

- 14.1 Asambleja e pergjithshme do te thirret nga administratoret te pakten njehere ne vit ne seline e Shoqërise ose ne cdo vend tjeter nese percaktohet ne njoftim.
- 14.2 Gjithashtu, ortakët te cilet perfaqesojne te pakten 20 perqind te totalit të votave në asamblene e pergjithshme te shoqërisë mund ti drejtojne administratoreve nje kerkese me shkrim ose nëpermjet postes elektronike per te thirrur asamblenë e pergjithshme. Në kerkesën drejtuar administratoreve mund te perfshihen dhe cështjet e posacme te rendit të ditës. Pas marrjes se kerkeses, jo me vone se 15 dite, administratori eshte i detyruar te njoftoje thirrjen e asamblese.
- 14.3 Asambleja e pergjithshme do te thirret me ane te nje njoftimi te shkruar të dërguar nga administratoret, njoftim ky i cili duhet te merret nga përfaqësuesit e ortakëve nëpërmjet nje letre rekomande, email , apo faksi jo me pak se 7 (shtate) dite perpara dates se caktuar te mbledhjes. Njoftimi i shkruar do te regjistrohet ne librin e procesverbalit te shoqërisë.  
Gjithashtu, asambleja e pergjithshme mund te thirret nëpërmjet postes elektronike me te njejtat kushte dhe afate.
- 14.4 Njoftimi për takimin e asamblese se pergjithshme do te tregojë datën kohën dhe vendin e takimit si dhe cështjet e rendit te ditës.
- 14.5 Nëse data për mbledhjen e ardhshme te asamblese eshte vendosur në takimin e fundit dhe te gjithë ortakët kane qene prezente, atëhere do të gjykohet sikur njoftimi eshte dërguar.
- 14.6 Nëse të gjithë ortakët janë prezente ne asamblene e ortakëve, atëherë vendimet mund te merren dhe ne mungesë të permbushjes së kërkesave formale te caktuara më sipër nese te gjithë ortakët janë dakord.

## **Neni 15**

### **Vendimet e marra ne asamblenë e pergjithshme**

- 15.1 Vendimet ne asamblene e pergjithshme te cilat kerkojne nje shumice te zakonshme mund te merren vetëm nese jane te pranishëm ortakët me të drejte vote qe zoterojne më shume se 30% të kuotave. Vendimet në asamblese e pergjithshme te cilat kerkojne shumice te kualifikuar mund te merrën vetëm nëse janë te pranishem ortakët te cilet zoterojne me shume së gjysmen e numrit total te votave.
- 15.2 Administratoret e shoqërise nuk mund të veprojnë si perfaqësues të ortakëve ne asamblene e pergjithshme.



- 15.3 Cdo ortak ka te drejte te therrase keshilltare ne mbledhjen e asamblese, të cilet do te jene te detyruar te ruajne fshehtësine e mbledhjes.
- 15.4 Nëse mbledhja e asamblese se pergjithshme thirret ne menyre te rregullt por nuk plotesohet numri i ortakëve te caktuar per te permbushur kuotimin, atehere asambleja do te thirret perseri ne perputhje me Nenin 14 dhe gjithmone jo me vone se 30 dite me te njëjtin rend dite.
- 15.5 Nese edhe pas thirrjes sipas pikes 15.4 te Nenit 15 nuk harrohet pjesemarrja sipas pikes te ketij Neni, atehere asambleja do te thirret perseri, ne perputhje me piken 15.4 te Nenin 15. Ne kete rast, vendimet do te miratohen me shumice te thjeshte apo te kualifikuar (sipas objektit te ceshtjes) te pjesemarrësve ne asamble.
- 15.6 Ortaket kane te drejte te perfaqesohen dhe te perfaqesojnë ne asamblene e pergjithshme nepermjet prokurave te posacme te cilat duhet te depozitohen ne sekretarine e shoqerise 48 ore perpara dates se mbajtjes se mbledhjes.

#### **Neni 16**

#### **Drejtimi i mbledhjes se asamblese se pergjithshme**

- 16.1 Kryetari i mbledhjes se asamblese se pergjithshme do te caktohet nga ortaket.
- 16.2 Do te aprovohen apo refuzohen vetem ato ceshtje te cilat jane percaktuar shprehimisht ne rendin e dites per mbledhjen e asamblese. Diskutimet mbi ceshtje te ndryshme nga ato te rendit te dites mund te behen vetem nese të gjithë ortaket japin pelqimin e tyre.

#### **Neni 17**

#### **Procesverbali i mbledhjes së asamblese se pergjithshme**

- 17.1 Për cdo mbledhje te asamblese se pergjithshme do te mbahet një procesverbal dhe do te merren vendime. Procesverbali duhet te mbaje datën, vendin e mbledhjes, rendin e dites, emrin e kryetarit dhe te mbajtësit të procesverbalit dhe rezultatet e votimit. Nje kopje e procesverbalit do te përgatitet për Shoqërine, nje per regjistrin tregtar dhe nje per secilin ortak. Procesverbali i bashkangjitet edhe lista e pjesëmarrësve së bashku me aktin e thirrjes se asamblese se pergjithshme.
- 17.2 Procesverbali do te firmoset nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.
- 17.3 Kopjet e vendimeve perkatese te ortakeve do t'u dergohen ortakëve me letër rekomande jo me vonë se 15 (pesëmbëdhjete) dite pas takimit te ortakëve.  
Nëse shoqëria ka publikuar ne faqe ne internet, nje kopje e procesverbalit do te publikohet jo me vonë se 15 dite nga data e mbledhjes ne këte faqe.
- 17.4 Administratori eshte pergjegjes për ruajtjen e kopjeve te procesverbalit dhe shpërndarjen e tij.

**PJESA V**  
**ADMINISTRIMI I SHOQERISE**

**Neni 18**  
**Administrimi i Shoqerisë**

18.1 Administrimi i shoqerise do te bëhet nga një ose me shume administratore, te cilet do te përfaqësojne Shoqërine. Gjithashtu, asambleja e pergjithshme secilit prej mund te caktojë kompetenca përfaqesimi individuale administratoreve.

18.2 Administratoret mund të autorizojne palet e treta qe t'i përfaqësojne ata ne transaksione dhe / apo çështje të vecanta.

18.3 Administratoret do te organizojne dhe menaxhojne te gjithë aktivitetin e Shoqerise. Ata jane te autorizuar te përfaqësojne Shoqerine ne te gjitha ceshtjet qe kane lidhje me te.

18.4 Te drejtat dhe detyrimet e administratoreve burojne nga ligji, ky Statut, vendimet e Asamblese se Pergjithshme dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.

18.5 Administratoret kane të drejtat e mëposhtme:

(a) përfaqesimin e Shoqerisë kundrejt paleve të treta dhe shtetit;

(b) hapjen e llogarive bankare të Shoqërise në bankat e nivelit të dyte, si dhe marrjen e kredencialeve dhe për perdorimin e shërbimeve online si dhe banking dhe te tjera me te njejta te drejta, detyrime dhe kufizime sikur keto shërbime do te kryheshin ne sportelet e bankave.

(c) perfundimin e marreveshjeve me palet e treta, leshimin dhe marrjen e urdher pagesave;

(d) nënshkrimin e te gjithë dokumentave, nxjerrjen e faturave, transferimet ne monedhe te huaj, flete ngarkesat etj, pagimin e detyrimeve te Shoqërise dhe pranimin e letrave me vlere nga palet e treta;

(e) mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërise, dhënien dhe marrjen e paradhënieve;

(f) dhënien e moratoriumit debitoreve te Shoqërise, hapjen dore nga padit qe vijne si pasoje e marrëdhënieve të Shoqërise me palet e treta dhe/ose pranimin e këtyre padive;

(g) punesimin dhe shkarkimin e stafit të Shoqërise, percaktimin e pagave, shperblimeve dhe pagesave te stafit;

(h) marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave te Shoqërise, fillimin e padive dhe marrjen persiper te mbrojtjes se Shoqerise në rast te padive kunder saj; administratoret mund te udhëzojne avokatet te mbrojnë Shoqërine dhe mund te percaktojnë shumën e shpërblimit te tyre; administratoret kane te drejte te ngrene padi dhe t'i terheqin ato, te nënshkruajnë marrëveshje gjyqesore, te mbyllin marreveshje arbitrazhi, te caktojne arbitra, te terheqin padite e ngritura nga Shoqeria dhe te nderprejne procedimet;

- (i) administratorët kanë të drejtë marrin çdo vendim tjetër që i takon aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikepamja e ligjit dhe këtij Statuti;
- (j) mbledhjen e shpenzimeve të Shoqërisë;
- (k) administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin dhe parimet e ligjit;
- (l) administratorët janë përgjegjës për përgatitjen dhe nënshkrimin e bilancit vjetor dhe pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe kontrollin nga auditor i jashtëm nëse dëkka e tillë kërkohet nga ligji apo vendimi i mbledhjes së ortakëve;
- (m) thirrjen e mbledhjeve të ortakëve, përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përmbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes së ortakëve për shpalljen e vendimeve të vecanta;
- (n) publikimin e shpalljeve të nevojshme përfshirë dhe publikimin e pasqyrave vjetore financiare;
- (o) administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e rregullt dhe ruajtjen e dokumentacionit të Shoqërisë;
- (p) ndryshimin e të dhënave të kontaktit të shoqërisë;
- (q) ndryshimin e selive të adresave sekondare të ushtrimit të aktivitetit.
- (r) marrin vendime mbi të gjitha çështjet e tjera që lidhen me aktivitetin e brendshëm të Shoqërisë dhe marrëdhëniet e saj të jashtme.
- (s) Administratori/et, veç e veç ose së bashku, kanë të drejtë dhe kompetencë të autorizojnë punonjësit e shoqërisë dhe / apo punonjes të pale të treta të personave juridike apo fizike që t'i përfaqësojnë ata dhe shoqërinë në transaksione ekonomike-financiare-juridike për të cilat nuk ka kufizim në statuti dhe Legjislacioni Tregtar dhe atë Civil.
- (t) Për çdo kontratë mbi 1 vit ose shitje-blerje asetesh, marrje dhenie hua, administratori duhet të marrë miratimin e asamblese.

18.6 Personi i identifikuar si më poshtë do të caktohet administrator i shoqërisë për një periudhë 3 (tre) vjeçare me të drejtë ripërteritje:

1. **Eris Tare**, atësia Gëzim, shtetas Shqiptar, lindur me 07/11/1990 në Kavajë, banues në Kavajë me adresë rruga Shengjergjit, Kavajë identifikuar me Letërnjoftim numer personal **J01107085H**, madhor dhe me zotësi të plote juridike për të vepruar.



**PJESA VI**  
**VITI FINANCIAR, BILANCI, FITIMI DHE HUMBJET**

**Neni 19**  
**Viti financiar, pasqyrat vetore financiare**

19.1 Viti financiar i Shoqërisë zgjat 12 muaj dhe fillon ne ditën e pare të Janarit dhe mbaron ne ditën e tridhjetë e një të Dhjetorit. Viti i pare financiar i Shoqërisë fillon ne datën e regjistrimit të Shoqërisë dhe mbaron ne daten e tridhjetë e një të Dhjetorit te vitit te regjistrimit.

19.2 Ne fund te cdo viti financiar, administratoret do te permbushin detyrat e mëposhtme:

(a) pergatitjen e nje liste te detajuar te asetëve te Shoqërisë dhe struktures se tyre;

(b) pergatitjen e pasqyrave financiare te shoqërisë i cili pershkruan situaten financiare te Shoqërisë;

(c) pergatitjen e llogarive te fitimit dhe te humbjeve.

19.3 Pasqyrat financiare te pergatitura do te paraqiten ne mbledhjen e zakonshme te asamblese se ortakeve per miratim, se bashku me nje raport te auditoreve te jashtem (nese eshte e detyrueshme nga legjislacioni apo kerkuar nga asambleja).

**Neni 20**  
**Fitimi i Shoqërisë**

20.1 Fitimi neto i Shoqërisë do te shpërndahet ne përputhje me pjesët e kapitalit në Shoqëri.

20.2 Fitimi neto do të jete fitimi i Shoqërisë në përputhje me pasqyrat vjetore financiare te miratuara pas zbritjes se te gjitha taksave dhe caktimit te rezervave ligjore. Hartimi i Pasqyrave Financiare të shoqërisë dhe dorezimi i tyre prane autoriteteve shtetërore do të behët sipas legjislacionit ne fuqi per kontabilitetin, legjislacionin fiskal dhe atij tregtar.

**PJESA VII**  
**PRISHJA DHE LIKUIDIMI**

**Neni 21**  
**Prishja dhe likuidimi**

21.1 Shoqëria do te zgjidhet në rastet e mëposhtme:

(a) vendim i mbledhjes së asamblesë ose

(b) bashkimi me një shoqëri tjeter;

(c) vendimi i gjykates me juridiksion përkatës ne rastet e parashikuara me ligj



(d)ne te gjitha rastet e tjera te parashikuara me ligj.

21.2 Likuidimi i Shoqerise dhe shpërndarja e asetëve të Shoqerisë do të bëhet në përputhje me dispozitat ligjore.

## PJESA VIII TE PERGJITHSHME

### Neni 22 Te pergjithshme

22.1 Në rast mosmarreveshjes të cilat lindin si pasoje e ketij Statuti ose per shkak te ligjit, ortakët do te perpiqen t'i zgjidhin ato miqësisht. Nëse nuk arrihet një marreveshje, mosmarreveshja e ortakëve do te zgjidhet nga gjykata me juridiksion perkates.

22.2 Ligji zbatues është ligji shqiptar.


22. Ky statut hartohet dhe nënshkruhet ne 2 (dy) kopje origjinale, ne Tiranë me 23/mars/2023

## ORTAKET E SHOQERISE

Startech Group sh.p.k.

Z. Sokol Salaj

Emer, mbiemer, firme



Znj. Jefa Starri

Emer, mbiemer, firme

